

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 5528 REP  
Nr 722 KOL 12



**KONTRATE  
E SHITJES SE AKSIONEVE**

Ne Tirane, sot me date 03.05.06, para meje noter Agim.Xh.Robo ,  
anetar i Dhomes se Notereve Tirane me zyre noterie ne rrugen Ismail Qemali,  
Pallati 27/1, u paraqiten personalisht palet kontraktuese me cilesite e  
meposhteme:

1. **Zoti ARTAN SEVRANI**, biri i Fetahut, dl.17.07.1966, lindur dhe banues ne  
Tirane, rruga "Sulejman Delvina" Pallati nr.1, ap.nr.11, identifikuar me pasaporte  
nr. Z1748715, me zotesi juridike e te plote per te vepruar.
2. **Zoti ARJAN LAMAJ**, biri i Xhaferrit, dl.1963, lindur dhe banues ne Tirane,  
rruga rruga "Qemal Stafa" Pallati 468/1, Prane Profarmes, me pasaporte nr.  
0924118, perfaqesuar ne kete kontrate nga zoti ARTAN SEVRANI, sipas  
prokures se posacme nr. 5527 rep 721 kol, date 03.05.2006

te cileve me poshte u referohemi **SHITESI**

dhe

1. Shoqeria "**ALBECORP**" SH.P.K. Regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane me  
Nr. Vendimi 12234 date 25.09.1995, Certificate Tatimore nr. 3606610, Nipt nr.  
J61824112G e perfaqesuar nga Administratoria e saj Zonja Edlira Margilaj e bija  
e Nikollaqit, lindur me 29 .03. 1968, identifikuar me pasaporte nr. Z1575873 , me  
zotesi juridike e te plote per te vepruar.

2. **SUZANA MARA**, bija e Fejzos, dl.25.04.1958, lindur dhe banuese ne Tirane,  
rruga "Mysylim Shyri" nr.130/1, identifikuar me pasaporte nr.Z 0594138, me  
zotesi juridike e te plote per te vepruar.

te cileve me poshte u referohemi **Bleresi**

Pas konstatohet statusi juridik i paleve te mesiperme, zotesia e plote juridike per  
te vepruar, me vullnetin e tyre te lire ata rane dakort te hartojne kontraten e  
shitjes se aksioneve duke u mbeshtetur ne kushtet si me poshte:

## KREU 1

### TERMAT E KONTRATES

"Shoqeri" do te kuptohet shoqeria "TELEVIZIONI ARBERIA" sh.a.me emer te shkurtuar "TVA".

"Aksione" do te kuptohet titulli qe perfaqeson pjesmarrjen ne kapitalin themeltar te shoqerise me te cilat lidhen te drejtat e aksionerit ne shoqeri, te percaktuara ne ligj dhe statutin e saj.

"Aksioner" do te kuptohet mbajtesi i aksioneve sipas certifikates te leshuar prej shoqerise.

"Certifikate aksionesh" do te kuptohet dokumenti i leshuar qe verteton pronesine e paketes se aksioneve.

"Gjykate kompetente" eshte gjykata e rrethit gjyqesor Tirane .

"Televizion" do te kuptohet televizioni TVA.

"Pajisje televizive" do te kuptohet teresia e pajisjeve qe jane aktualisht prone e shoqerise si dhe gjithë atyre qe cilesohen te nevojshme dhe qe i sherbejne veprimtarise normale te televizionit.

"Financime" do te kuptohet vlera e nevojshme per shpenzimet dhe investimet dhe permiresimet teknike qe do te behen per televizionin.

"Investime" do te kuptohen shpenzimet e nevojshme per zhvillimin e metejshem te televizionit TVA.

"Politike televizive" do te kuptohet teresia e programacionit te TVA, karakteri informativ dhe linja editoriale e programacionit, pavaresia e televizionit nga cdo force politike.

## KREU II

### TE DHENA PARAPRAKE

1. -Sipas dokumentacionit te shoqerise, aksionet e te cilave ne menyre te pjeseshme vihen ne shitje dhe sipas Regjistrimit te Aksioneve, shoqeria ushtron veprimtarine e saj televizive ne baze te ligjit 8410 date 30.09.1998 "Per Radion dhe Televizionin Publik e Privat ne Republiken e Shqiperise" dhe Vendimit gjyqesor nr.22058 dat 04.10.1999 te gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, me seli ne rrugen e Kavajes, nr.34/1, me seli operative ne godinen Pallati I Madh I Kultures, me Kod Fiskal 3709115,NIPT K11807009G

2. - Aksionere te kesaj shoqerie jane :

- Zoti ARDIAN TAKAJ, zoterues i 40 % te aksioneve ose 4800 aksioneve, i cili nuk eshte pale ne kete Kontrate.

- Zoti ARTAN SEVRANI , zoterues i 20% te aksioneve ose 2400 aksione, i cili deshiron t'i shese tersisht ato tek Bleresi Zonja SUZANA MARA ne kete Kontrate.

- Zoti ARJAN LAMAJ, zoterues i 40% te aksioneve ose 4800 aksione, i cili deshiron t'i shese teresisht ato tek Bleresi shoqeria "ALBECORP"SH.P.K. ne kete Kontrate.

Pas kryerjes se procedurave ligjore ne lidhje me shitjen e aksioneve sipas Statutit dhe ligjit 7638 date 19.11.1992, dhe ne perputhje me nenin 20 paragrafi 3 te Ligjit nr.8410, date 30.09.1998 "Per Radion dhe Televizionin Publik e Privat ne RSH", hartohet kjo Kontrate e shitjes se Aksioneve ndermjet paleve te paraqitura ne hyrje te saj.

## Neni 1. OBJEKT I KONTRATES

Objekti i kesaj Kontrate eshte :

- **Shitja** e paketes prej 20% (njezete per qind ) te aksioneve ose 2400 aksione te shitesit Aksioner ARTAN SEVRANI dhe blerja e tyre e plote ne raportin e ofruar (20% te totalit te kapitalit themeltar ) nga ana e Bleresit, Zonjes SUZANA MARA.
- **Shitja** e paketes prej 40% (dyzete per qind ) te aksioneve ose 4800 aksione te shitesit Aksioner ARJAN LAMAJ dhe blerja e tyre e plote ne raportin e ofruar ( 40% te totalit te kapitalit themeltar ) nga ana e Bleresit shoqeria "ALBECORP"SH.P.K.

## KREU III Neni 2. CMIMI

Cmimi i shitjes percaktohet :

- 2.1. - **20% (njezete per qind )** te aksioneve ose 2400 aksione , te Zotit ARTAN SEVRANI shiten tek zonja SUZANA MARA , perkundrejt cmimit prej 466.666 ( katerqinde e gjashtedhete e gjashte mije e gjashteqinde e gjashtedhete e gjashte ) Euro. Ne kete cmim perfshihen te gjitha detyrimet qe shoqeria ka ndaj te treteve etj. brenda vleres te aksione qe zoteron shitesi.
- **2.2. - 40% (dyzete per qind )** te aksioneve ose 4800 aksione te Zoti ARIAN LAMAJ shiten tek shoqeria "ALBECORP"SH.P.K. perkundrejt cmimit prej 933.333 (nenteqind e tridhete e tre mije e treqinde e tridhete e tre ) Euro. Ne kete cmim perfshihen te gjitha detyrimet qe shoqeria ka ndaj te treteve etj , ne vleren e aksione qe zoteron shitesi
- 2.3. - Aksionet, objekt shitje perfaqesojne kapitalin themeltar te shoqerise "TELEVISIONI ARBERIA " sh.a. me emer te shkurtuar "TVA", ne te cilin jane perfshire pajisje teknike, aparatura , financime, investime gjithecka perben kapitalin themeltar dhe aktivin percaktuar ne statut dhe bilancin e saj .

- Pas nenshkrimit te kesaj kontrate dhe plotesimit te detyrimeve kontraktore gjendja e aksioneve ne shoqerine „TELEVIZIONI ARBERIA “ sh.a. emer i shkurtuar „TVA“ eshte :

- Zoti ARDIAN TAKAJ, zoterues i 40% te aksioneve (te cilat nuk jane objekt shitje).

- Zonja SUZANA MARA , zoteruese e 20 % te aksioneve.

- Shoqeria „ALBECORP“SH.P.K., zoterues i 40% te aksioneve.

2.4. - Pas nenshkrimit te kesaj Kontrate, ne Regjistrin e Aksioneve te shoqerise „TELEVIZIONI ARBERIA “ sh.a. do te regjistrohen Aksioneret e rinj, numri i aksioneve te transferuara ,numri i aksioneve zoteruese per secilin Aksioner.

Do te kryhet pajisja me certifikatat perkatese te pronesise mbi aksionet.

### Neni 3

#### MENYRA E PAGESES :

3.1.- Sipas cmimit te percaktuar ne nenin 2, shuma e percaktuar per blerjen e 20% te aksioneve te Shitesit ARTAN SEVRANI, nga bleresi Zonja SUZANA MARA , do te paguhet si me poshte:

- Kesti i pare prej 50 000 Euro kash, brenda muajit Maj 2006 e vertuar kjo me nje konferme bankare.

- Kesti dyte prej 233.333 (dyqinde e tridhjetete e tre mije e treqinde e tridhjetete e tre ) Euro, do te paguhet brenda dates 30.07.2006.

- Kesti i trete prej 183.333 (njqind e tetedhjetete e tre mije e treqinde e tridhjetete e tre ) Euro, do te paguhet brenda dates 30.10.2006.

3.2. - Sipas cmimit te percaktuar ne nenin 2, shuma e percaktuar per blerjen e 40% te aksioneve te Shitesit Zoti ARJAN LAMAJ nga bleresi Shoqeria „ALBECORP“SH.P.K. do te paguhet ne kater keste si me poshte :

- Kesti i pare prej 50 000 Euro kash, brenda muajit Maj 2006 e vertuar kjo me nje konferme bankare.

- Kesti i dyte prej 233.333 (dyqinde e tridhjetete e tre mije e treqinde e tridhjetete e tre ) Euro, do te shlyhet brenda dates 30.01.2007.

- Kesti i trete prej 233.333 (dyqinde e tridhjetete e tre mije e treqinde e tridhjetete e tre ) Euro, do te shlyhet brenda dates 30.04.2007.

- Kesti i kater prej 233.333 (dyqinde e tridhjetete e tre mije e treqinde e tridhjetete e tre ) Euro, do te shlyhet brenda dates 30.07.2007.

- Kesti i peste prej 183.333 (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqindë e tridhjetë e tre) Euro, do të shlyhet brenda datës 30.10.2007.

#### Neni 4

#### DEKLARATA TE PALEVE

##### 4.1.- Shitesit deklarojnë se :

- Shoqëria TELEVISIONI ARBERIA nuk është nën vartësi dhe procedurave falimentare apo të likuidimit dhe që aksionet janë të lira nga çdo lloj barre, detyrimi, pengu apo hipoteke

- Frekuencat janë të vlefshme dhe nuk janë në rrezik

- Shoqëria zotëron licencë kombëtare, të pakufizuar dhe të pandryshueshme nr.02/TVK për transmetimin në rrugë tokësore, nëpërmjet sinjalit televiziv për Shqipërinë. (shih lidhja 1)

Godina ku ushtron veprimtarinë TVA ndodhet në adresën Pallati I Madh I Kultures, objekt i kontraktuar me qera me subjektin qeradhënës Q.T.Z.K.

##### 4.2. - Palet garantojnë perkatesisht :

- Marrin përsiper të përbushin të gjitha detyrimet perkatese kontraktore brenda afatëve të parashikuara në këto kontrate. Blerësi "ALBECORP" SH.P.K. brenda datës 30.06.2006, do të japë garanci bankare të leshuar nga "Raiffeisen Bank" sh.a Tirane, në vlerën totale 1 300 000 (njemilijon e treqind mijë euro) si pjesë e transaksionit të shitjes së kuotave në favor të shitesave. Blerësi "ALBECORP" SH.P.K merr përsiper që garancia të mbulojë dhe detyrimin e blerëses Suzana MARA në favor të shitesit Artan SEVRANI. Ekzekutimi i garnacisë do të bëhet sipas grafikut të shlyerjeve parashikuar në kontrate. Shitesat kanë të drejtë që të tërheqin shumat perkatese në një bankë të zgjedhur prej tyre. Ato kanë të drejtë të trajtojnë me bankën garantuese ose me ndonjë bankë tjetër, marrjen e një kredie mbi bazën e kesaj garancie.


- Garancia bankare mbas hyrjes në fuqi por jo me vonë se data e parashikuar, nuk mund të preket apo të pezullohet për çfarëdo problemi që mund të dalë nga ekzekutimi i kesaj kontrate nga blerësi.

Mos dhenia e garancisë bankare brenda afatit 30.06.2006 nga shitesat, e bën kontratën e shitblerjes të anulueshme në kuptimin e plotë të saj.

##### 4.3 - EFEKTET E KONTRATES MBI PRONESINË E AKSIONEVE TË SHOQËRISË "TELEVISIONI ARBERIA" SH.A. në shoqërinë "SAT +"

Sipas vendimit nr.32164 datë 22.09.2004 të gjykates së rrethit gjyqësor Tirane në Regjistrin Tregetar, shoqëria "TELEVISIONI ARBERIA" sh.a. është një ndër aksioneret, zotëruese e 33.33 % të aksioneve në Shoqërinë Anonime "SAT +" sh.a.

Sipas aksioneve të blera me këto kontrate, perkatesisht 40% Shoqëria "ALBECORP" SH.P.K. dhe 20% zonja SUZANA MARA, percaktohet në këto



kontrate edhe pjesmarrja e tyre ne raportet e mesiperme ne 33.33% te Aksioneve zoteruese te shoqerise "TELEVISIONI ARBERIA " sh.a. tek Shoqeria "SAT +"sh.a.

#### KAPITULLI IV

### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE

#### TE DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITESIT

##### NENI 5

5.1. - Shitesit kane detyrimin qe te njohin blesesit si pronare te aksioneve te shitura ne momentin e nenshkrimimit te kesaj kontrate. Ata humbasin cilesine e tyre si Aksioner dhe cdo te drejte qe rrjedh nga kjo cilesi, mbas vertetimit te kushtit te parashikuar ne paragrafin e fundit te nenit 4.2. Shitesit deklarojne besueshmerine e te dhenave ne lidhje me gjendjen e shoqerise sipas bilanceve te vena ne dispozicion te paleve blesese.

Blesesit behen pronare te paketes se aksioneve te percaktuar per secilin prej tyre sipas Neni 1 te kesaj kontrate.

5.2.- Shitesit deklarojne garancine se gjendja e shoqerise ne momentin e nenshkrimimit te Kontrates .

5.3.- Ne rast se blesit terhiqen nga fillimi dhe ekzekutimi i kesaj kontrate, pra nuk japin garancine bankare, shuma e parapaguar Kash ne favor te te dy shitesve, nuk u kthehet atyre duke ju mbajtur si penalitet.

- persa l perket kapitalit themeltar te saj,  
- te drejtave te pronesise se shoqerise mbi sendet e luajtshme, pajisjeve teknike e cdo gje te nevojshme, do te jete e njejte si ne lidhjet qe l bashkengjiten kesaj kontrate.



5.4.Pala shitesese detyrohet te respektojte kushtet me nenshkrimin e kesaj Kontrate, deri ne ditën e rregjistrimit te saj dhe publikimin e aksionereve te rinj ne Regjistrin Tregetar ne baze te Ligjit 7638 date 19.11.1992. Ajo nuk ka te drejte te kryeje asnje negociate dhe asnje veprim juridik per shitje ne te trete.Ne rast te kundert detyrohet te c`demtojte per pasojat e ardhura nga shkelja e ketij kushti kontraktor

#### TE DREJTAT E DETYRIMET E BLERESIT

##### NENI 6

6.1. - Blesesit angazhohen te paguajne cmimin e percaktuar ne kontrate sipas menyres dhe afateve te percaktuar ne kontrate.

6.2.- Blesesit angazhohen ne pjesmarrjen ne politiken e televizionit "TELEVISIONI ARBERIA " sh.a. e cila eshte dhe duhet te mbetet e pavarur, neutrale dhe konstruktive, si dhe te vene ne dispozicion te gjitha burimet e nevojshme per nje rendiment te mire te shoqerise.



6.3 - Bleresit kane te drejte te vendosin sipas zoterimit te tyre te aksioneve lidhur me politiken televizive, perberjen e stafit, emerimin dhe shkarkimin e drejtoreve, rritjen e kapitalit, emetim te aksioneve etj ne perputhje me Statutin dhe ligjin.

## KUSHTE TE TJERA KONTRAKTORE

### NENI 7.

Palet deklarojne kryerjen e Auditimit Financiar brenda dates 15 maj 2006, ngarkuar per kete qellim Zoti KRISTAQ NDINI, Ekspert Kontabl I Autorizuar, anetar I IKA, me nr.License 88 si dhe per kontrollin e pajisjeve televizive (aparatura etj) ngarkohet ing.AGRON ARANITASI.

Pala blerese njih dhe merr persiper shumat qe perbejne debi per aq sa kuota qe ato do te perfaqsojne ne shoqeri "TELEVIZIONI ARBERIA "sh.a. te deklaruar dhe evidentuara ne llogarite e saj deri ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

Gjendja debitor ndaj te treteve e shoqerise TVA pra e 100% te kuotave te ortakeve te saj, eshte ne shumen prej **78.040.000 leke**

Cdo detyrim qe do te evidentohet tej vleres se mesiperme, pas dates se nenshkrimit te Kontrates dhe me pas, do te jete ne ngarkim te paleve shitese.

Per cdo proces gjyqesor te lindur ne rast konflikti midis ish aksionereve te shoqerise, midis shoqerise dhe te treteve, per ceshtje te lindura para dates se nenshkrimit te kesaj kontrate, pergjigjet pala shitese.

### NENI 8.

- Pagesat nga Bleresat tek Shitesat perkatesisht sipas aksioneve te shitura 40% dhe 20% do te behen perkundrejt paraqitjes te dokumentacionit qe shitesi do ti njoftoje bleresit sipas situacioneve perkatese


## FORMA E KONTRATES

### NENI 9

- Kjo kontrate lidhet ne forme te shkruar ne 6 (gjashte) ekzemplare me vlere te njejte provuese. Nje prej tyre depozitohet prane kesaj zyre noteriale.Te tjerat u dorezohen paleve perkatesisht.

## LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

### NENI 10



10.1.- Ligji I aplikueshem ne kete kontrate eshte :

- Ligji nr. 8410 date 30.09.1998 "Per Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise"
- Ligji nr. 7638 date 18.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

- Dispozitat e pergjitheshme per Kontratat ne pergjithesi dhe Dispozitat e Posacme per-Kontraten e Shitjes te Kodit Civil te RSH.

10.2. - Te gjitha mosmarrevshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi I kushteve te kesaj Kontrate, jane objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykates kompetente shqiptare.


Sa me sipër, Kjo Kontrate u hartua prej meje Noter Agim Xh. Robo, ajo ne perfundim te saj, iu lexua paleve me ze te larte, te cilet deklaruan se kuptuan permbajtjen e saj, jane dakort pa asnje verejtje dhe nenshkruajne me vullnetin e tyre te lire.

U mor nenshkrimi I paleve, vene rregullisht baze ligjit dhe u vertetua prej meje Noterit.

### PALET PJESMARRESE

#### SHITESAT

##### 1. ARTAN SEVRANI

*Artan Sevrani*  
  
\_\_\_\_\_

##### 2. ARJAN LAMAJ Perfaqesuar nga ARTAN SEVRANI

*Artan Sevrani*  
\_\_\_\_\_



#### BLERESAT

##### 1. SHOQERIA "ALBECORP" SH.P.K. Perfaqesuar nga Administratore EDLIRA MARGILAJ

*Edlira Margilaj*  
\_\_\_\_\_



##### 2. SUZANA MARA

*Suzana Mara*  
\_\_\_\_\_



#### NOTER

*Agim Xh. Robo*  